



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.73, datë 1.10.2018

PËR

“RREGULLIMIN E TARIFAVE TË SIPËRMARRËSIT ALBTELECOM SH.A. ME FUQI TË NDJESHME NË TREG PËR TREGUN ME SHUMICË TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETIN PUBLIK TELEFONIK TË LËVIZSHËM ALBTELECOM SH.A”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës __.__.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom”

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 55 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
3. VKD Nr.11 datë 22.02.2018 për "*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar”*
4. Vendim Nr.14 datë 22.02.2018 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”*
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP (VKD) Nr.70, date 1.10.2018, “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare–Dokument përfundimtar”*”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-vendimi për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom”*
2. Dokumenti: *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar.*
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (**Relacioni**).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 për "*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar” dhe me Vendimin Nr. 14, datë 22.2.2018, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”, ka përcaktuar Albtelecom sh.a sipërmarrës me FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të Albtelecom.*

2. Këshilli Drejtus AKEP, pas procedurës 30 ditore të këshillimit publik, me Vendimin Nr.70, date 1.10.2018, miratoi dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”. Ky dokument:
 - a) është përgatitur në përputhje me nenin 55 të Ligjit 9918 pas procedurës së këshillimit publik dhe ka marrë në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara, përfshirë Albtelecom¹, dhe komentet kryesore dhe qëndrimi i AKEP për komentet është pjesë e tij (Aneks 1);
 - b) ka marrë në konsideratë praktikatat më të mira në vendet e BE dhe rajonit dhe kushtet e tregut Shqiptar;
 - c) është përgatitur në përputhje me përcaktimet në dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar”, miratuar me VKD Nr.11, datë 22.2.2018, dhe përcaktimet e VKD Nr.14, datë 22.2.2018, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”;
 - d) përmban arsyetimin për metodat e rregullimit të tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve të tre sipërmarrësve me FNT të rrjeteve celulare, përfshirë Albtelecom përcaktuar me FNT me VKD Nr.12, date 22.2.2018.
3. Dokumenti “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar” i miratuar me VKD Nr.70, date 1.10.2018, shërben si pjesë arsyetuese për marrjen e këtij vendimi për rregullimin e tarifave të Albtelecom sh.a i përcaktuar me FNT me VKD Nr.14, datë 22.2.2018.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Në përputhje me Nenin 57, pika 1/a e Ligjit 9918, metoda e rregullimit të tarifave të Albtelecomsh.a i përcaktuar me FNT² në tregun përkatës me shumicë të terminimit të

¹ Dërguar nga nëpërmjet shkresës Nr.2745, datë 28/03/2018, “Komentet e Albtelecom mbi dokumentin e nxjerrë për këshillim publik “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare-Këshillim Publik 2”;

² VKD nr.14, datë 22.2.2018.

thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të Albtelecom³, është *përcaktimi i nivelit maksimal* sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëm:

	Aktuale	01.12.2018	01.12.2019-deri në një vendim tjetër të AKEP
Tarifa maksimale e Terminimit të thirrjeve (<i>Lek/minutë pa TVSH</i>)	1.48	1.22	1.11

2. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. Alban **KARAPICI**
2. Edlira **DVORANI**
3. Ketrin **TOPÇIU**
4. Klarina **ALLUSHI**

³ Përkufizimi i tregut përkatës është dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut dhe statusi me FNT është vetëm për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare.